

**VENDIM**  
**Nr. 929, datë 19.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR ETIKETIMIN E PAJISJEVE  
FRIGORIFERIKE PËR PËRDORIM SHTËPIAK NË LIDHJE ME KONSUMIN E ENERGJISË”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e pajisjeve frigoriferike për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij në datën 1 qershor 2013.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**RREGULL TEKNIK**  
**PËR ETIKETIMIN E PAJISJEVE FRIGORIFERIKE PËR PËRDORIM SHTËPIAK NË LIDHJE ME  
KONSUMIN E ENERGJISË**

**1. Përmbajtja dhe fusha e përdorimit**

1.1 Ky rregull teknik përcakton kërkesat për etiketimin dhe informacionin plotësues për pajisjet frigoriferike për përdorim shtëpiak që furnizohen me energji elektrike me një vëllim të ruajtjes nga 10 deri 1500 litra.

1.2 Ky rregull teknik zbatohet për pajisjet frigoriferike për përdorim shtëpiak që furnizohen me energji elektrike, duke përfshirë edhe ato që shiten për përdorim joshhtëpiak apo për ftohjen e artikujve të tjerë, përveç atyre ushqimore, duke përfshirë edhe ato të parashikuara për t’u instaluar në një dollap (ose të inkazuara).

Ky rregull teknik zbatohet gjithashtu për pajisjet frigoriferike që punojnë me energji elektrike që furnizohen me bateri.

**1.3 Ky rregull teknik nuk zbatohet për:**

a) pajisjet frigoriferike që furnizohen kryesisht nga burime të tjera të energjisë elektrike, të tilla si: gazi i lëngshëm (LPG), vajguri dhe karburante biodizel;

b) pajisjet frigoriferike me bateri që mund të lidhen me linjat kryesore me anë të një konvertuesi AC/DC, të blerë veç;

c) pajisjet frigoriferike të bëra me porosi vetëm një herë për një pajisje dhe që nuk janë të njëvlershme me modele të tjera të pajisjeve frigoriferike;

d) pajisjet frigoriferike për përdorim në sektorin terciar, ku heqja e artikujve ushqimorë frigoriferikë bëhet në mënyrë elektronike dhe ku informacioni mund të transmetohet automatikisht me anë të lidhjes në rrjet në një sistem të kontrollit në distance për llogaritë;

e) pajisjet ku funksioni parësor nuk është ruajtja e artikujve ushqimorë nëpërmjet ftohjes, të tilla si pajisje vetëm për bërjen e akullit ose ato për përgatitjen e pijeve të ftohta.

**2. Përkufizime**

Për qëllime të këtij rregulli teknik, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

2.1 “Artikuj ushqimorë” janë ushqimet, përbërësit e tyre, pijet, duke përfshirë verën dhe artikuj të

<sup>1</sup> Rregullorja e Parlamentit Europian nr. 1060/2010 e datës 28 shtator 2010 “Për etiketimin e pajisjeve frigoriferike për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”.

tjerë, të cilët janë kryesisht për konsumim që kërkojnë ftohje në temperatura të caktuara.

2.2 “Pajisje frigoriferike për përdorim shtëpiak” është një kabinë e izoluar termikisht me një ose më shumë ndarje, e parashikuar për ftohjen ose ngrirjen e artikujve ushqimorë, ose për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ftohtë apo të ngrirë për qëllime joprofesionale, të ftohura nga një ose më shumë procese të konsumit të energjisë, duke përfshirë edhe pajisjet që shiten si pjesë për t’u montuar nga përdoruesi i fundit (më poshtë referohet “pajisje frigoriferike”).

2.3 “Pajisje e parashikuar për t’u instaluar në një dollap” është një pajisje e palëvizshme frigoriferike e parashikuar të instalohet në një kabinë, në një zgavër të përgatitur më parë në mur, ose vend tjetër të ngjashëm, dhe që kërkon mbyllje të mobiluara.

2.4 “Frigorifer” është pajisja frigoriferike e parashikuar për ruajtjen e artikujve ushqimorë me të paktën një ndarje të përshtatshme për ruajtjen e ushqimeve të freskëta dhe/ose pijeve, duke përfshirë edhe verën.

2.5 “Pajisje frigoriferike tip me kompresion” është pajisja frigoriferik në të cilën ftohja bëhet me anë të një motor-kompresori.

2.6 “Pajisje frigoriferike tip me absorbim” është pajisja frigoriferike e cila si burim energjie për ftohje përdor nxehtësinë e krijuar nga procesi i absorbimit.

2.7 “Frigorifer me ngrirje” është pajisja frigoriferike me të paktën një ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të freskët dhe të paktën një ndarje të përshtatshme për ngrirjen e artikujve ushqimorë të freskët, si dhe ruajtjen e tyre të ngrira sipas kushteve të ruajtjes me tri yje (ndarja për ngrirje të thellë).

2.8 “Kabinë për ruajtjen e artikujve ushqimorë në gjendje të ngrirë” është pajisja frigoriferike me një ose më shumë ndarje të përshtatshme për ruajtjen e artikujve ushqimorë në gjendje të ngrirë.

2.9 “Ngrirës për artikuj ushqimorë” është pajisja frigoriferike me një ose më shumë ndarje të përshtatshme për ngrirjen e artikujve ushqimorë në intervale të temperaturave që shkojnë nga temperatura e ambientit duke zbritur deri në -18°C dhe që është, gjithashtu, i përshtatshëm për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë nën kushtet e ruajtjes me tri yje. Gjithashtu, një ngrirës i artikujve ushqimorë mund të përfshijë edhe seksionet me dy yje dhe/ose ndarje brenda ndarjes apo kabinës.

2.10 “Pajisje për ruajtjen e verës” është pajisja frigoriferike që nuk ka ndarje tjetër përveç një ose më shumë ndarjeje për ruajtjen e verës.

2.11 “Pajisje me shumë përdorime” është pajisja frigoriferike që nuk ka ndarje përveç një ose më shumë ndarjeve për shumë përdorime.

2.12 “Pajisje e njëvlershme frigoriferike” është një model i pajisjes frigoriferike e vendosur në treg me të njëjtën madhësi dhe volum të ruajtjes, me të njëjtat karakteristika teknike të efikasitetit e performancës dhe të njëjtë tipa ndarjesh, me një model tjetër frigoriferik të vendosur në treg nga i njëjti prodhues nën një tjetër numër të kodit tregtar.

2.13 “Përdorues i fundit” është një përdorues që ka blerë ose pritet të blejë një pajisje frigoriferike.

2.14 “Pika e shitjes” është vendi (ose ambient) ku paraqiten, ofrohen për shitje, qira apo blerje me këste pajisjet frigoriferike.

2.15 “Sistemi antibrymë” është një sistem automatik që parandalon formimin e vazhdueshëm të brymës, ku ftohja sigurohet nga qarkullimi i ajrit të ngjeshur dhe ku aparati ose aparatet avullues çbrymosen nga një sistem automatik i shkrirjes dhe uji që krijohet nga shkrirja eliminohet automatikisht.

2.16 “Ndarje antibrymë” është çdo ndarje ku çbrymosja bëhet nga një sistem antibrymë.

2.17 “Frigorifer me ndarje me temperaturë mesatare” është një pajisje frigoriferike, e cila ka të paktën një ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të freskët dhe një ndarje me temperaturë mesatare, por nuk ka ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë, të ftohtë apo për bërjen e akullit.

2.18 “Pajisje me temperaturë mesatare” është një pajisje frigoriferike, që ka vetëm një ose më shumë ndarje në temperaturë mesatare.

2.19 “Frigorifer ftohës” është një pajisje frigoriferike, e cila ka të paktën një ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të freskët dhe një ndarje ftohëse, por nuk ka ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë.

2.20 “Ndarje” është çdo ndarje e listuar në pikat nga “g” deri në “n”.

2.21 “Ndarja për ruajtjen e artikujve ushqimorë të freskët” është një ndarje e parashikuar për ruajtjen e artikujve ushqimorë të pangrirë, e cila vetë mund të ketë nënndarje.

2.22 “Ndarja në temperaturë mesatare” është një ndarje për ruajtjen e artikujve të veçantë ushqimorë ose të pijeve në temperaturë më të lartë se ajo e ndarjes për ruajtjen e artikujve ushqimorë të freskët.

2.23 “Ndarje ftohëse” është një ndarje posaçërisht e parashikuar për ruajtjen e artikujve ushqimorë që prishen shpejt.

2.24 “Ndarje për bërjen e akullit” është një ndarje me temperaturë të ulët e parashikuar vetëm për ngrirjen dhe ruajtjen e akullit.

2.25 “Ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë” është një ndarje me temperaturë të ulët e parashikuar vetëm për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë dhe e klasifikuar sipas temperaturës si më poshtë:

a) “Ndarja me një yll”: një ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë, ku temperatura nuk është më e lartë se - 6°C;

b) “Ndarja me dy yje”: një ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë, ku temperatura nuk është më e lartë se - 12°C;

c) “Ndarja me tri yje”: një ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë, ku temperatura nuk është më e lartë se - 18°C;

d) “Ndarje për artikuj ushqimorë me ngrirje të thellë (ose ndarje me katër yje)”: një ndarje e përshtatshme për ngrirjen e të paktën 4,5 kg artikuj ushqimorë për 100 litra të vëllimit të ruajtjes dhe në asnjë rast më pak se 2 kg, duke sjellë nga temperatura e ambientit deri në - 18°C për një periudhë prej 24-orësh, e cila gjithashtu është e përshtatshme për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë sipas kushteve të ruajtjes me tri yje dhe që mund të përfshijë seksione me dy yje brenda ndarjes;

e) “Ndarja 0 yll”: një ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë, në të cilën temperatura është <0°C dhe që, gjithashtu, mund të përdoret për ngrirjen dhe ruajtjen e akullit, por nuk është parashikuar për ruajtjen e artikujve ushqimorë që prishen shumë shpejt;

2.26 “Ndarje për ruajtjen e verës” është ndarja e projektuar posaçërisht për ruajtjen e verës ose për një kohë të shkurtër për të sjellë verën në temperaturën më të përshtatshme të pijeve, ose për një kohë të gjatë për të lejuar maturimin e verës sipas veçorive të mëposhtme:

a) temperaturë konstante e ruajtjes, e paracaktuar ose e rregulluar manualisht në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, në intervalin nga + 5°C deri në + 20°C;

b) temperatura(t) e ruajtjes brenda një harku të dhënë kohor, që varion(jnë) më pak se 0,5 K për çdo temperaturë të deklaruar të ambientit, e specifikuar sipas klasës klimatike për pajisjet frigoriferike;

c) kontrolli aktiv ose pasiv i lagështisë në ndarje ndërmjet nga 50% deri në 80%;

d) e konstruktuar për të zvogëluar transmetimin e vibrimit në ndarje, si nga kompresori i frigoriferit apo nga ndonjë burim i jashtëm.

2.27 “Ndarje me shumë përdorime” është ndarja që mund të përdoret në dy ose më shumë temperatura që i korespondojnë tipave të ndryshëm ndarjesh, që përdoruesi i fundit mund të rregullojë për të mbajtur vazhdimisht intervalin e temperaturës së funksionimit, që zbatohet në çdo tip ndarjeje sipas udhëzimeve të prodhuesit. Megjithatë, kur kemi një funksion që lejon ndryshimin e temperaturës në një ndarje në një interval të ndryshëm nga temperatura e funksionimit, vetëm për një periudhë të kufizuar kohe (si p.sh. mundësi e ngrirjes së shpejtë), kjo ndarje nuk është një “ndarje me shumë përdorime”, si përcaktohet në këtë rregull teknik.

2.28 “Ndarje tjetër” është një ndarje, përveç ndarjes për ruajtjen e verës, e parashikuar për ruajtjen e artikujve të veçantë ushqimorë në një temperaturë më të lartë se + 14°C.

2.29 “Seksion me dy yje” është pjesë e një ngrirësi për artikuj ushqimorë, e një ndarje me katër yje (ndarje për artikuj ushqimorë me ngrije të thellë), e një ndarje me tri yje ose e një kabinë tri yje për ruajtjen e artikujve ushqimorë në gjendje të ngrirë, e cila nuk ka derë të veçantë ose kapak dhe ku temperatura nuk është më e lartë se -12°C.

2.30 “Ngrirës në formë sënduku”, është një frigorifer ngrirës për artikuj ushqimorë, në të cilin ndarja(et) është(janë) e(të) përdorshme nga pjesa e sipërme e pajisjes ose që ka dy tipa ndarjesh, si me hapje nga sipër, ashtu dhe vertikale, por kur madhësia e hapjes së ndarjes nga sipër kalon 75% të madhësisë së pajisjes.

2.31 “Tip me hapje nga sipër” ose “tip në formë sënduku” është një pajisje frigoriferike me ndarjen/et e saj që përdoret nga pjesa e sipërme e pajisjes;

2.32 “Tip vertikal” është pajisja frigoriferike me ndarje të saj që përdoret nga pjesa e përparme e pajisjes.

2.33 “Ngrirje e shpejtë” është një veçori e kthyeshme që aktivizohet nga përdoruesi i fundit sipas udhëzimeve të prodhuesit, që ul temperaturën e ngrirësit ose të ndarjes së ngrirësit, për të arritur ngrirje të shpejtë të artikujve ushqimorë jo të ngrirë.


2.34 “Identifikues modeli” është kodi, zakonisht alfanumerik, që dallon një model të veçantë frigoriferik nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose emër furnizuesi.

### 3. Etiketa

#### 3.1 Informacioni në etiketë

Çdo pajisje frigoriferike në pikën e shitjes ka të vendosur etiketën të dhënë nga furnizuesit, në atë mënyrë që ajo të jetë qartësisht e dukshme në pjesën e përparme ose në pjesën më të sipërme të pajisjes.

3.2 Etiketa për pajisjet frigoriferike që klasifikohen në klasat e efikasitetit të energjisë nga A+++ deri në C



a) Në këtë etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Modeli identifikuar nga furnizuesi;

III. Klasa e efikasitetit të energjisë e përcaktuar në përputhje me pikën 10, ku drejtimi i shigjetës që përmban klasën e efikasitetit të energjisë së pajisjes frigoriferike për përdorim shtëpiak, duhet të vendoset në të njëjtën lartësi me drejtimin e shigjetës së klasës përkatëse të efikasitetit të energjisë;

IV. Konsumi vjetor i energjisë (AEC) në kwh në vit, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 9.3(b);

V. Shuma e vëllimeve të ruajtjes të të gjitha ndarjeve pa yll (d.m.th. që veprojnë në temperaturë > -6°C), e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VI. Shuma e vëllimeve të ruajtjes të të gjitha ndarjeve për ruajtjen e artikujve ushqimorë në gjendje të ngrirë që vlerësohen me një yll (d.m.th. që veprojnë në temperaturë ≤ -6°C), e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe numri i yjeve i asaj ndarje që zë pjesën më të madhe të kësaj shume. Kur pajisja frigoriferike për përdorim shtëpiak nuk ka ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë në gjendje të ngrirë, furnizuesi duhet të deklarojë “- L” në vend të vlerës dhe të lërë bosh vendin e parashikuar për vendosjen e yjeve;


VII. Emetimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura të shprehura në dB(A) kundrejt 1 pW, të rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

Megjithatë, për pajisjet e ruajtjes së verës, pikat V dhe VI zëvendësohen me kapacitetin nominal të shprehur si numër shishesh standarde prej 75 centilitërsh që mund të përmbajë pajisja sipas udhëzimeve të prodhuesit.

b) Format i etiketës duhet të jetë në përputhje me pikën 3.4 (a). Kur një modeli i është dhënë etiketa “EU Eco”, mund të shtohet një kopje e kësaj etikete.

G


### 3.3 Etiketa për pajisjet frigoriferike që klasifikohen për klasat e eficientës së energjisë nga D deri në



- a) Në këtë etiketë përfshihen të dhënat e shënuara në pikën 3.1 (a).  
b) Formati i etiketës duhet të jetë në përputhje me pikën 3.3 (b). Kur një modeli i është dhënë etiketa “EU Eco”, mund të shtohet edhe një kopje e kësaj etikete.

#### 3.4. Formati i etiketës

- a) Formati i etiketës për pajisjet frigoriferike që klasifikohen në klasat e eficientës së energjisë nga A+++ deri në C, me përjashtim të pajisjeve për ruajtjen e verës, duhet të jetë në përputhje me figurën e mëposhtme:



Ku:

- Etiketa duhet të jetë të paktën 110 mm e gjerë dhe 220 mm e lartë. Kur etiketa është printuar në format më të madh, përmbajtja e saj duhet të mbetet në përpjesëtim me specifikimet e mësipërme.
  - Sfondi i etiketës duhet të jetë i bardhë.
  - Ngjyrat duhet të jenë KKVZ – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, sipas këtij shembulli: e kaltër 00-70-X-00: 0 %, e kuqe e purpurt 70%, e verdhë 100%, e zezë 0%.
  - Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat në vijim (numrat i referohen figurës së mësipërme):
    - Korniza e jashtme e etiketës 5 pt: ngjyra e kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.
    - Logo EU - ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
    - Etiketa e energjisë: ngjyra: X-00-00-00.
- Piktograma si e paraqitur: logo EU + etiketa e energjisë: gjerësia: 92 mm, lartësia: 17 mm.
4. Korniza e nënlogove: ngjyra -1 pt: E kaltër 100% - gjatësia: 92,5 mm.

5. Shkalla A-G

- Shigjeta: lartësia: 7 mm, hapësira: 0,75 mm

ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00,

Klasa e dytë: 70-00-X-00,

Klasa e tretë: 30-00-X-00,

Klasa e katërt: 00-00-X-00,

Klasa e pestë: 00-30-X-00,

Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,

Klasa e fundit: 00-X-X-00.

- Teksti: kalibri **bold** 19 pt, germa kapitale dhe të bardha “+” simbolet: kalibri **bold** 13 pt, germa kapitale, i bardhë, të vendosura vetëm në një rresht.

6. Klasa e efencës së energjisë

- Shigjeta: gjerësia: 26 mm, lartësia: 14 mm, 100% e zezë;

- Teksti: kalibri **bold** 29 pt, germa kapitale dhe të bardha “+”: simbolet: kalibri **bold** 18 pt, germa kapitale, i bardhë dhe të vendosura vetëm në një rresht.

7. Energjia

- Teksti: kalibri i rregullt 11 pt, germa kapitale, e zezë.

8. Konsumi vjetor i energjisë:

- Korniza: ngjyra -3 pt: e kaltër 100% - rakordimet në kënde 3,5 mm.

- Vlera: kalibri **bold** 45 pt, 100% e zezë.

- Rreshti i dytë: kalibri i rregullt 17 pt, 100% e zezë.

9. Vëllimet e ruajtjes të të gjitha ndarjeve që nuk vlerësohen me një yll:

-Korniza: ngjyra -3 pt: e kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.

- Vlera: kalibri **bold** 25 pt, 100% e zezë. kalibri i rregullt 17 pt, 100% e zezë.

10. Emetimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura:

- Korniza: ngjyra -3 pt: e kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.

- Vlera: kalibri **bold** 25 pt, 100% e zezë.

Kalibri i rregullt 17 pt, 100% e zezë.

11. Vëllimet e ruajtjes të të gjitha ndarjeve për ruajtjen e artikujve ushqimore në gjendje të ngrirë me yll/yje:

- Korniza: ngjyra -3 pt: e kaltër 100% - këndet të rrumbullakëta: 3,5 mm.

- Vlera: kalibri **bold** 25 pt, 100% e zezë.

Kalibri i rregullt 17 pt, 100% e zezë.

12. Emri i furnizuesit ose marka tregtare


13. Modeli identifikues i furnizuesit

14. Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe modeli identifikues duhet të përshtaten në një hapësirë 90 x 15 mm.

15. Identifikimi i rregullit teknik

Teksti: kalibri **bold** 11 pt.

b) Për pajisjet frigoriferike që klasifikohen në klasat e efencës së energjisë nga D deri në G, përveç pajisjeve për ruajtjen e verës, formati i etiketës duhet të jetë si më poshtë:



Ku:

Formati i etiketës duhet të jetë në përputhje me pikën 4.3 (a), përveç numrit 8, ku zbatohet:


8. Konsumi vjetor i energjisë:

- Korniza: ngjyra- 3 pt: E kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.

- Vlera: kalibri *bold* 32 pt, 100% e zezë.

- Rreshti i dytë: kalibri i rregullt 14 pt, 100% e zezë.

c) Për pajisjet e ruajtjes së verës, formati i etiketës duhet të jetë si më poshtë:



Ku:

i) Etiketa duhet të jetë të paktën 110 mm e gjerë dhe 220 mm e lartë. Kur etiketa është printuar/shtypur në një format më të mëdha, përmbajtja e saj duhet të mbetet në përpjesëtim me specifikimet e mësipërme.

ii) Sfondi i etiketës duhet të jetë i bardhë.

iii) Ngjyrat duhet të jenë CMYK – E kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull: E kaltër 00-70-X-00: 0%, e kuqe e purpurt 70%, e verdhë 100%, e zezë 0%.

- iv) Etiketa duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës më lart):
1. Korniza e jashtme e etiketës: ngjyra -5 pt: E kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.
  2. Logo EU - ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
  3. Etiketa e energjisë: ngjyra: X-00-00-00.
- Piktograma paraqitur, si: logo EU + etiketa e energjisë: gjerësia: 92 mm, lartësia: 17 mm.
4. Korniza e nënlogove: ngjyra -1 pt: E kaltër 100% - gjatësia: 9 2,5 mm.
  5. Shkalla A-G
    - Shigjeta: Lartësia: 7 mm, hapësira: 0,75 mm - ngjyrat: Klasa më të lartë: X-00-X-00, Klasa së dytë: 70-00-X-00, Klasa e tretë: 30-00-X-00, Klasa e katërt: 00-00-X-00, Klasa e pestë: 00-30-X-00, Klasa e gjashtë: 00-70-X-00, Klasa (at) e fundit: 00-X-X-00.
    - Teksti: kalibri **bold** 19 pt, germa kapitale dhe të bardha “+” simbolet: kalibri **bold** 13 pt, germa kapitale, të bardha dhe të vendosura vetëm në një rresht.
  6. Klasa e efikasitetit të energjisë- Shigjeta: gjerësia: 26 mm, lartësia: 14 mm, 100% e zezë;
    - Teksti: kalibri **bold** 29 pt, germa kapitale, të bardha; simbolet “+”: kalibri **bold** 18 pt, germa kapitale, të bardha dhe të vendosura vetëm në një rresht.
  7. Energjia
    - Teksti: kalibri i rregullt 11 pt, germa kapitale, e zezë.
  8. Konsumi vjetor i energjisë:
    - Korniza: ngjyra -2 pt: E kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.
    - Vlera: kalibri **bold** 30 pt, 100% e zezë.
    - Rreshti i dytë: kalibri i rregullt 14 pt, 100% e zezë.
  9. Kapaciteti nominal i shprehur në numër shifresh standarde të verës:
    - Korniza: ngjyra -2 pt: e kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.
    - Vlera: kalibri **bold** 28 pt, 100% e zezë.
    - Kalibri i rregullt 15 pt, 100% e zezë.
  10. Emetimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura:
    - Korniza: ngjyra -2 pt: E kaltër 100% - rakordimet në kënde: 3,5 mm.
    - Vlera: kalibri **bold** 25 pt, 100% e zezë.
    - Kalibri i rregullt 17 pt, 100% e zezë.
  11. Emri i furnizuesit ose marka tregtare
  12. Modeli identifikues i furnizuesit
  13. Emri i furnizuesve ose marka tregtare dhe modeli identifikues duhet të përshtaten në një hapësirë 90 × 15 mm
  14. Identifikimi i rregullit teknik:
    - Tekst: kalibri **bold** 11 pt.
  4. Skeda informative e produktit

4.1 Informacioni i dhënë në skedën informative të pajisjes frigoriferike duhet të përfshihet në broshurën e produktit ose në çdo dokumentacion tjetër që shoqëron produktin sipas renditjes së mëposhtme:

- a) emri i furnizuesit ose marka tregtare;
- b) identifikimi i modelit të furnizuesit si e përkufizuar në pikën 2.34;
- c) kategoria e modelit të pajisjes frigoriferike në përputhje me pikën 9.1;
- d) klasa e efikasitetit të energjisë së modelit, në përputhje me pikën 10;
- e) kur modelit i është dhënë etiketa “EU Eco”, mund të përfshihet ky informacion;
- f) konsumi vjetor i energjisë (AE C) në kWh në vit, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 9.3 (b). Ai përshkruhet si: “Konsumi i energjisë “XYZ” kWh në vit,

bazuar në rezultatet e provës standarde për 24 orë. Konsumi aktual i energjisë varet nga mënyra se si përdoret pajisja dhe se ku është e vendosur”;

g) vëllimi i ruajtjes për çdo ndarje dhe nëse ka, numrin e yjeve në përputhje me pikën 3.2 (a) VI;

h) temperatura e projektuar e “ndarjeve të tjera” sipas kuptimit të pikës 2.28. Për ndarjen e ruajtjes së verës jepet temperatura më e ftohtë e ruajtjes, ose e paravendosur në ndarje apo e mundshme për t’u vendosur nga përdoruesi i fundit në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;

i) referimi “antibrymë” për ndarjen/t përkatëse, siç përcaktohet në pikën 2.16;

j) siguria e ruajtjes me ndërprerjen e energjisë “X” “h” përkufizohet si “koha deri në rritjen e temperaturës;

k) “kapaciteti i ngrirjes në kg/24 h;

l) “klasa klimatike” në përputhje me pikën 9.1, tabela 3, dhe e shprehur si: “Klasa klimatike: W [klasa klimatike]. Kjo pajisje është parashikuar të përdoret në temperaturën e ambientit midis “X” [temperatura më e ulët] °C dhe “X” [temperatura më e lartë] °C;

m) emetimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura të shprehura në dB(A) kundrejt 1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

n) një tregues kur modeli është parashikuar të instalohet në një dollap;

o) për pajisjet e ruajtjes së verës, informacioni i mëposhtëm: “Kjo pajisje është parashikuar që të përdoret ekskluzivisht për ruajtjen e verës”. Kjo pikë nuk zbatohet për pajisjet frigoriferike për përdorim shtëpiak që nuk janë të projektuara posaçërisht për ruajtjen e verës, por megjithatë mund të përdoren për këtë qëllim dhe as për pajisjet frigoriferike që kanë një ndarje për ruajtjen e verës të kombinuar me ndonjë tip tjetër ndarje .

4.2 Një skedë informative mund të mbulojë disa modele të pajisjeve frigoriferike të furnizuara nga i njëjti furnizues.

4.3 Informacioni i dhënë në skedën informative mund të jepet në formën e një kopjeje të etiketës, me ngjyra ose bardhë e zi. Në rastin e fundit, duhet të jepet informacioni i listuar në pikën 4.1 që nuk është dhënë në etiketë.

4.4 Bëhet e disponueshme një skedë informative e pajisjes frigoriferike.

## 5. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik vihet në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut me kërkesën e saj

5.1 Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë:

a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

b) një përshkrim të përgjithshëm të modelit të pajisjes frigoriferike, në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të identifikueshëm;

c) ku kërkohen referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara;

d) sipas rastit, standarde të tjera teknike dhe specifikime teknike të përdorura;

e) identifikimi dhe nënshkrimi i personit të autorizuar të lidhur me furnizuesin;

f) parametrat teknikë të matjeve të përcaktuar në përputhje me pikën 13;

i) dimensionet e përgjithshme;

ii) hapësira e përgjithshme e kërkuar në përdorim;

iii) vëllimi(et) i përgjithshëm bruto;

iv) vëllimi(et) i ruajtjes dhe vëllimi(et) i përgjithshëm total i ruajtjes;

v) numri i yjeve të ndarjes/ve të ruajtjes së artikujve ushqimorë në gjendje të ngrirë;

vi) tipi antibrymë/i shkrirjes;

vii) temperatura e ruajtjes;

viii) konsumi i energjisë;

ix) koha deri në rritjen e temperaturës, në rastin e ndërprerjes së energjisë elektrike;

x) kapaciteti ngrirjes;

xi) konsumi i energjisë;

xii) lagështia në ndarjen e ruajtjes së verës;

xiii) emetimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura;

g) rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me pikën 9.

5.2 Kur informacioni i përfshirë në dosjen e dokumentacionit teknik për një model të veçantë të

pajisjes frigoriferike, është marrë nga llogaritjet në bazë të projektit ose nga ekstrapolimi i pajisjeve të tjera frigoriferike të njëvlershme, ose nga të dyja bashkë, dokumentacioni duhet të përfshijë detaje të këtyre llogaritjeve apo ekstrapolimeve ose të dyja bashkë, dhe të testeve të bëra nga furnizuesit për të verifikuar saktësinë e llogaritjeve të kryera.

Informacioni gjithashtu duhet të përfshijë një listë të të gjitha modeleve të tjera të njëvlershme të pajisjeve frigoriferike kur informacioni sigurohet mbi të njëjtën bazë.

6. Informacioni që sigurohet në rastet kur përdoruesi i fundit nuk parashikohet të shikojë produktin

6.1 Informacioni duhet të jepet sipas renditjes së mëposhtme:

a) klasa e efikasitetit të energjisë të modelit siç përcaktohet në pikën 10;  
b) konsumi vjetor i energjisë në kWh në vit, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 9.3 (b);

c) vëllimi i ruajtjes për çdo ndarje, dhe nëse ka, numri i yjeve në përputhje me pikën 3.2 (a)VI;

d) “klasa klimatike” në përputhje me pikën 9.1, tabela 3;

e) emetimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura i shprehur në dB (A) kundrejt 1 pW, rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

f) një tregues nëse modeli është i parashikuar për t’u instaluar në një dollap;

g) për pajisjet për ruajtjen e verës, informacionin e mëposhtëm: “Kjo pajisje është parashikuar të përdoret vetëm për ruajtjen e verës”. Kjo pikë nuk zbatohet për pajisjet frigoriferike që nuk janë të projektuara veçanërisht për ruajtjen e verës, por megjithatë mund të përdoren për këtë qëllim, dhe as për pajisjet frigoriferike që kanë një ndarje për ruajtjen e verës të kombinuar me ndonjë tip tjetër ndarjeje.

6.2 Madhësia dhe forma e shkronjave për informacionin e referuar në këtë pikë duhet të jenë qartësisht të lexueshëm kur printohet ose tregohet.

6.3 Çdo publicitet apo material promovues teknik që i përket një modeli specifik të pajisjes frigoriferike dhe që përshkruan parametra specifik teknik të saj të përmbajë klasën e efikasitetit të energjisë të këtij modeli.

6.4 Pajisjet frigoriferike të ofruara për shitje, qira apo blerje me këste, tregtohen së bashku me informacionin e dhënë më sipër.

## 7. Matjet

### 7.1 Metodat e matjes

Për qëllimet e zbatimit dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e këtij rregulli teknik, matjet duhet të bëhen duke përdorur një procedurë të besueshme, të saktë dhe të ripërsëritshme që merr parasysh metodat e përgjithshme të matjes brenda teknologjisë bashkëkohore të njohur, duke përfshirë metodat e përcaktuara në dokumente, numrat e referencës të së cilave janë botuar për këtë qëllim në Fletoren Zyrtare.

### 7.2. Kushtet e përgjithshme për testim

Kushtet e përgjithshme për testim zbatohen si më poshtë:

a) nëse janë parashikuar pajisje ngrohëse antikondesuese që mund të ndizen dhe fiken nga përdoruesi i fundit, ato duhet të jenë të ndezura, dhe nëse rregullohen, të vendosen në ngrohje maksimale;

b) nëse ka pajisje të tjera në derën e pajisjes frigoriferike, (të tilla si: pajisjet e nxjerrjes së akullit ose të ujit/pijeve të ftohta) që mund të aktivizohen dhe çaktivizohen nga përdoruesi i fundit, ato duhet të jenë të aktivizuara gjatë matjes së konsumit të energjisë, por jo në përdorim;

c) për pajisjet dhe ndarjet me shumë përdorime, temperatura e ruajtjes gjatë matjes së konsumit të energjisë duhet të jetë temperatura nominale e tipit të ndarjes më të ftohtë e specifikuar për përdorim të vazhdueshëm normal sipas udhëzimeve të prodhuesit;

d) konsumi i energjisë i pajisjes frigoriferike duhet të përcaktohet në konfigurimin më të ftohtë, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për përdorim të vazhdueshëm normal për çdo “ndarje tjetër” siç përcaktohet në pikën 9, tabela 5.

### 7.3 Parametrat teknikë

Parametrat e mëposhtëm duhet të përcaktohen:

a) “dimensionet e përgjithshme”, që vlerësohen me milimetrin më të afërt;

b) “hapësira e përgjithshme e kërkuar në përdorim”, që vlerësohet me milimetrin më të afërt;

- c) “vëllimi/et total bruto që vlerësohet/vlerësohen me numrin e plotë më të afërt në decimetër kub ose litra;
- d) “vëllimi/et e ruajtjes dhe vëllimi/et totale të ruajtjes” që vlerësohet me numrin e plotë më të afërt në decimetra kub ose litra;
- e) “tipi i shkrirjes/antibrymë”;
- f) “temperatura e ruajtjes”;
- g) “konsumi i energjisë” i cili shprehet në kilovat/orë në 24 orë (kWh/24h), me tre numra pas presjes dhjetore;
- h) “koha deri në rritjen e temperaturës”, në rastin e ndërprerjes së energjisë elektrike;
- i) “kapaciteti i ngrirjes”;
- j) lagështia në ndarjen e ruajtjes së verës”, që shprehet në përqindje e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt; dhe
- k) “emërtimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura”.

#### 8. Procedura e verifikimit për qëllime të mbikëqyrjes së tregut.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të përdorë procedura të besueshme, të sakta dhe të ripërsëritshme të matjeve që marrin parasysh metodat e teknologjisë së njohur bashkëkohore duke përfshirë dhe metodat e publikuara në Fletoren Zyrtare.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, për qëllime të kontrollit të përputhshmërisë duhet të testojë vetëm një pajisje frigoriferike.

Nëse parametrat e matur nuk përputhen me vlerat e deklaruar nga furnizuesi brenda vlerave të dhëna në tabelën 1, matjet bëhen në tri pajisje frigoriferike të tjera. Mesatarja aritmetike e vlerave të matura të këtyre tri pajisjeve frigoriferike duhet të plotësojnë kërkesat brenda intervalit të vlerave të përcaktuara.

Në të kundërtën, modeli dhe të gjitha pajisjet e tjera frigoriferike quhen si të papërshtatshme.

Tabela 1

| Parametri i matur                                          | Tolerancat e verifikimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vëllimi nominal bruto                                      | Vlera e matur nuk duhet të jetë më e vogël se 3% ose 1 litër e vlerës nominale (*), cilado qoftë vlera më e madhe.                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Vëllimi nominal i ruajtjes                                 | Vlera e matur nuk duhet të jetë më e vogël se 3% ose 1 litër e vlerës nominale, cilado qoftë vlera më e madhe.<br>Kur vëllimet e ruajtjes të artikujve ushqimorë në ndarjen në temperaturë mesatare dhe të freskët janë të rregullueshme në lidhje me njëra-tjetrën nga përdoruesi i fundit, kjo pasiguri e matjes zbatohet kur ndarja në temperaturën mesatare është rregulluar në minimumin e vëllimit të saj. |
| Kapaciteti i ngrirjes                                      | Vlera e matur nuk duhet të jetë më e vogël se 10% e vlerës nominale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Konsumi i energjisë                                        | Vlera e matur nuk duhet të jetë më e madhe se 10% e vlerës nominale (E 24h).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Pajisjet për ruajtjen e verës                              | Vlera e matur për lagështinë relative nuk duhet të tejkalojë intervalin nominal me më shumë se 10%.                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Emetimet e zhurmës akustike në ambiente të hapura          | Vlera e matur duhet të përputhet me vlerën nominale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| (*) Vlera nominale është vlera e deklaruar nga fabrikuesi. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

9. Klasifikimi i pajisjeve frigoriferike, metodat për llogaritjen e vëllimit të barasvlershëm dhe indeksit të efikasitetit të energjisë

#### 9.1 Klasifikimi i pajisjeve frigoriferike

Pajisjet frigoriferike për përdorim shtëpiak klasifikohen në kategori siç listohen në tabelën 1.

Çdo kategori përcaktohet sipas përmbajtjes së ndarjeve siç tregohet në tabelën 2 dhe kjo varet nga numri i dymëve dhe/ose sirtarëve.

TABELA 1  
KATEGORITË E PAJISJEVE FRIGORIFERIKE

| Kategoria | Projektimi |
|-----------|------------|
|-----------|------------|

|    |                                                                                                        |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1  | Frigorifer me një ose më shumë ndarje për ruajtjen e artikujve ushqimorë të freskët                    |
| 2  | Frigorifer me ndarje në temperaturë mesatare, pajisje me temperaturë mesatare dhe për ruajtjen e verës |
| 3  | Frigorifer ftohës dhe frigorifer me një ndarje me 0 yll                                                |
| 4  | Frigorifer me një ndarje me një yll                                                                    |
| 5  | Frigorifer me një ndarje me dy yje                                                                     |
| 6  | Frigorifer me një ndarje me tri yje                                                                    |
| 7  | Frigorifer me ngrirje                                                                                  |
| 8  | Ngrirës vertikal                                                                                       |
| 9  | Ngrirës në formë sënduku                                                                               |
| 10 | Pajisje frigoriferike me shumë përdorime dhe të tjera                                                  |

Pajisjet frigoriferike që nuk mund të klasifikohen në kategoritë 1 deri 9 për shkak të temperaturës së ndarjes klasifikohen në kategorinë 10.

TABELA 2  
KLASIFIKIMI I PAJISJES FRIGORIFERIKE DHE KOMPOZIMI I NDARJEVE PËRKATËSE

| T Temperatura nominale<br>(për EEI) °C)                                                                                         | Projekti T T | + + 112            | + 112                | + + 5 5                          | 0 0 0  | 0 0                           | -- 6       | -- 12  | -- 18   | -- 18     | Kategoria<br>(numri) |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|--------------------|----------------------|----------------------------------|--------|-------------------------------|------------|--------|---------|-----------|----------------------|
| Tipat e ndarjeve                                                                                                                | Të tjera     | Ruajtja e<br>verës | Temperatura mesatare | Ruajtja në<br>gjendje të freskët | Ftohës | 0 yje/për bërjen e<br>akullit | Një<br>yll | Dy yje | Tri yje | Katër yje |                      |
| Kategoria e pajisjes                                                                                                            |              |                    |                      |                                  |        |                               |            |        |         |           |                      |
| Frigorifer me një ose më shumë<br>ndarje për ruajtjen gjendje të<br>freskët                                                     | N            | N                  | N                    | Y                                | N      | N                             | N          | N      | N       | N         | 1                    |
| Frigorifer me ndarje në<br>temperaturë mesatare dhe<br>pajisje me ndarje në<br>temperaturë mesatare dhe për<br>ruajtjen e verës | O            | O                  | O                    | Y                                | N      | N                             | N          | N      | N       | N         | 2                    |
|                                                                                                                                 | O            | O                  | Y                    | N                                | N      | N                             | N          | N      | N       | N         |                      |
|                                                                                                                                 | N            | Y                  | N                    | N                                | N      | N                             | N          | N      | N       | N         |                      |
| Frigorifer ftohës dhe frigorifer<br>me një ndarje me 0 yll                                                                      | O            | O                  | O                    | Y                                | O      | O                             | O          | N      | N       | N         | 3                    |
|                                                                                                                                 | O            | O                  | O                    | Y                                | O      | O                             | O          | Y      | N       | N         |                      |
| Frigorifer me një ndarje me një<br>yll                                                                                          | O            | O                  | O                    | Y                                | O      | O                             | Y          | N      | N       | N         | 4                    |
| Frigorifer me një ndarje<br>me dy yje                                                                                           | O            | O                  | O                    | Y                                | O      | O                             | O          | Y      | N       | N         | 5                    |
| Frigorifer me një ndarje<br>me tri yje                                                                                          | O            | O                  | O                    | Y                                | O      | O                             | O          | O      | Y       | N         | 6                    |
| Frigorifer me ftohje të thellë                                                                                                  | O            | O                  | O                    | Y                                | O      | O                             | O          | O      | O       | Y         | 7                    |
| Ngrirës vertikal                                                                                                                | N            | N                  | N                    | N                                | N      | N                             | N          | O      | (Y) (a  | Y         | 8                    |
| Ngrirës në formë sënduku                                                                                                        | N            | N                  | N                    | N                                | N      | N                             | N          | O      | N       | Y         | 9                    |
| Pajisje me shumë përdorime<br>dhe të tjera                                                                                      | O            | O                  | O                    | O                                | O      | O                             | O          | O      | O       | O         | 10                   |

Shënime

Y = ka ndarje;

N = nuk ka ndarje;

O = prania e ndarjes është fakultative;

a) gjithashtu, përfshin kabinat me tri yje për artikuj ushqimorë të ngrirë.

Pajisjet frigoriferike janë klasifikuar për një ose më shumë klasa klimatike siç janë specifikuar në tabelën 3.

TABELA 3  
KLASAT KLIMATIKE

| Klasa                   | Simboli | Temperatura mesatare e ambientit °C |
|-------------------------|---------|-------------------------------------|
| Shtrirja e temperaturës | SN      | nga + 10 në + 32                    |
| Temperatura             | N       | nga + 16 në + 32                    |
| Subtropikale            | ST      | nga + 16 në + 38                    |
| Tropikale               | T       | nga + 16 në + 43                    |

Pajisja frigoriferike duhet të mundësojë mbajtjen e temperaturave të kërkuara të ruajtjes në ndarje të ndryshme, në të njëjtën kohë dhe brenda devijimeve të lejuara të temperaturës (gjatë ciklit antibrymë/të shkrirjes) për lloje të ndryshme të pajisjeve frigoriferike dhe për klasat e përshtatshme klimatike siç është përcaktuar në tabelën 4.

Pajisjet dhe ndarjet me shumë përdorime duhet të mundësojnë mbajtjen e temperaturave të kërkuara të ruajtjes për tipa të ndryshëm ndarjesh kur këto temperatura mund të rregullohen nga përdoruesi i fundit sipas udhëzimeve të prodhuesit.

TABELA 4  
TEMPERATURAT E RUAJTJES

| Temperaturat e ruajtjes (°C) |                               |                                |                                                                                      |                             |                   |                  |                                                                            |
|------------------------------|-------------------------------|--------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------|------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| Ndarje tjetër                | Ndarja e ruajtjes së verës    | Ndarje me temperaturë mesatare | Ndarja për artikuj ushqimorë të freskët                                              | Ndarja e ftohjes            | Ndarja me një yll | Ndarja me dy yje | Ndarja për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë dhe kabinë me tri yje/ |
| t <sub>om</sub>              | t <sub>wma</sub>              | t <sub>cm</sub>                | t <sub>1m</sub> , t <sub>2m</sub> , t <sub>3m</sub> , t <sub>ma</sub>                | t <sub>cc</sub>             | t*                | t**              | t***                                                                       |
| > + 14                       | + 5 ≤ t <sub>wma</sub> ≤ + 20 | + 8 ≤ t <sub>cm</sub> ≤ + 14   | 0 ≤ t <sub>1m</sub> , t <sub>2m</sub> , t <sub>3m</sub> ≤ + 8; t <sub>ma</sub> ≤ + 4 | - 2 ≤ t <sub>cc</sub> ≤ + 3 | ≤ - 6             | ≤ - 12 ( a )     | ≤ - 18 ( a )                                                               |

#### Shënime

- t<sub>om</sub>: temperatura e ruajtjes e ndarjes tjetër.
- t<sub>wma</sub>: temperatura e ruajtjes në ndarjen e ruajtjes së verës me një variacion 0,5 K.
- t<sub>cm</sub>: temperatura e ruajtjes në ndarjen me temperaturë mesatare.
- t<sub>1m</sub>, t<sub>2m</sub>, t<sub>3m</sub>: temperaturat në ndarjen e ruajtjes së artikujve ushqimorë të freskët.
- t<sub>ma</sub>: temperatura mesatare e ruajtjes në ndarjen e artikujve ushqimorë të freskët.
- t<sub>cc</sub>: temperatura e ruajtjes e menjëhershme e ndarjes ftohëse.
- t\*, t\*\*, t\*\*\*: temperatura maksimale e ndarjeve për ruajtjen e artikujve ushqimorë të ngrirë.
- temperatura e ruajtjes për ndarjen e bërjes së akullit dhe për ndarje "0 yll" është nën 0°C.

a) për pajisjet frigoriferike antibrymë, gjatë ciklit antibrymë/të shkrirjes nuk lejohet shmangia e temperaturës më shumë se 3 K gjatë 4 orëve ose 20% e zgjatjes së ciklit të punës, cilado qoftë më e vogla.

#### 9.2 Llogaritja e vëllimit të njëvlershëm

Vëllimi i njëvlershëm i pajisjes frigoriferike është shuma e vëllimeve të njëvlershme të të gjitha ndarjeve. Ai llogaritet në litra dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt, si:

$$V \text{ eq } \frac{1}{4} " X c \frac{1}{4} n c \frac{1}{4} 1 V c \ddot{U} \delta 25 - T c \text{ } \text{ } 20 \ddot{U} F F c \# \ddot{U} C C \ddot{U} B I$$

ku:

- n është numri i ndarjeve;
- Vc është vëllimi ruajtjes i ndarjes/ve;
- Tc është temperatura nominale e ndarjes/ve siç është përcaktuar në tabelën 2;
- δ25 – T c 20 është faktori termodinamik, siç përcaktohet në tabelën 5;
- FF c, CC dhe BI janë faktorët e korrigjimit të vëllim, siç është përcaktuar në tabelën 6.

Faktori korrighues termodinamik  $\delta_{25-T}$  c-të 20 është diferenca midis temperaturës nominale të një ndarje  $T_c$  (përcaktuar në tabelën 2) dhe temperaturës së ambientit në kushtet e provës standarde në  $+ 25^\circ\text{C}$ , e shprehur si raport me të njëjtën diferencë për ndarjen e artikujve ushqimorë të freskët në  $+ 5^\circ\text{C}$ .

Faktorët termodinamikë për ndarjet e përshkruara në pikat 2.21 deri në 2.28, janë paraqitur në tabelën 5.

**TABELA 5**  
**FAKTORËT TERMODINAMIKË PËR NDARJET E PAJISJEVE FRIGORIFERIKE**

| Ndarje                                                     | Temperatura nominale | $(25-T_c)/20$ |
|------------------------------------------------------------|----------------------|---------------|
| Ndarje tjetër                                              | $+ 12$               | 0,65          |
| Ndarje me temperaturë mesatare/ndarja për ruajtjen e verës | $+ 5^\circ\text{C}$  | 1,00          |
| Ndarja e ruajtjes së artikujve ushqimorë të freskët        | $0^\circ\text{C}$    | 1,25          |
| Ndarja ftohëse                                             | $0^\circ\text{C}$    | 1,25          |
| Ndarja për bërjen e akullit dhe ndarja 0 yje               | $- 6^\circ\text{C}$  | 1,55          |
| Ndarja me një yll                                          | $- 12^\circ\text{C}$ | 1,85          |
| Ndarja me dy yje                                           | $- 18^\circ\text{C}$ | 2,15          |
| Ndarja me tri yje                                          | $- 18^\circ\text{C}$ | 2,15          |

Shënim:

i) Për ndarjet me shumë përdorime, faktori termodinamik përcaktohet nga temperatura nominale e ndarjes më të ftohtë të mundshme që vendoset nga përdoruesi i fundit dhe mbahet vazhdimisht në përputhje me udhëzimet e prodhuesit siç është dhënë në tabelën 2;

ii) Për çdo seksion me dy yje (brenda një frigoriferi), faktori termodinamik përcaktohet në

$T_c = - 12^\circ\text{C}$ ;

iii) Për ndarjet e tjera, faktori termodinamik përcaktohet nga temperatura më e ftohtë e mundshme e projektuar, që vendoset nga përdoruesi i fundit dhe mbahet vazhdimisht në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

**TABELA 6**  
**VLERA E FAKTORËVE TË KORRIGJIMIT**

| Faktori i korrighimit   | Vlera | Kushtet                                                           |
|-------------------------|-------|-------------------------------------------------------------------|
| FF (me ngrirje të lirë) | 1,2   | Për ruajtjen e artikujve ushqimorë në ndarjet me ngrirje të lirë. |
|                         | 1     | Të tjera                                                          |
| CC (klasa e klimës)     | 1,2   | Për pajisjet e klasës T (tropikale)                               |
|                         | 1,1   | Për pajisjet e klasës ST (subtropikale)                           |
|                         | 1     | Të tjera                                                          |
| BI (të konstruktura)    | 1,2   | Për pajisjet e konstruktura me gjerësinë nën 58 cm                |
|                         | 1     | Të tjera                                                          |

Shënime

i) FF është faktori i korrighimit të vëllimi për ndarjen antibrymë;

ii) CC është faktori i korrighimit të vëllimit për një klasë klimatike të dhënë. Nëse një pajisje frigoriferike është klasifikuar në më shumë se në një klasë klimatike, klasa klimatike me faktorin e korrighimit më të lartë përdoret për llogaritjen e vëllimit të njëvlershëm;

iii) BI është faktor i korrighimit të vëllimit të pajisjes së parashikuar për t'u instaluar në një dollap.

9.3. Llogaritja e indeksit të efikasitetit të energjisë.

Për llogaritjen e indeksit të efikasitetit të energjisë (EEI) të një modeli të pajisjes frigoriferike, konsumi vjetor i energjisë së pajisjes frigoriferike krahasohet me konsumin standard vjetor të energjisë.

a) Indeksi i efikasitetit të energjisë (EEI) llogaritet dhe rumbullakoset me një shifër pas presjes

dhjetore, si:

AE c SAE c  $\ddot{U}$  100 EEI  $\frac{1}{4}$

ku:

AE C = konsumi vjetor i energjisë së pajisjes frigoriferike .

SAE C = konsumi vjetor standard i energjisë i pajisjes frigoriferike.

b) Konsumi vjetor i energjisë (AEC) llogaritet në kWh /vit dhe rumbullakoset në dy shifra pas presjes dhjetore, si:

$AEC = E \times 24h \times 365$

ku:

E 24h është konsumi i energjisë së pajisjes frigoriferike në kWh/24h dhe rumbullakoset me tri shifra pas presjes dhjetore.

c) Konsumi vjetor standard i energjisë (SAEC) llogaritet në kWh/ në vit dhe rumbullakoset me dy shifra pas presjes dhjetore, si:

$SAE C = Veq \times M + N + CH$

ku:

Veq është vëllimi i njëvlershëm i pajisjes frigoriferike,

CH është e barabartë me 50 kWh/në vit për pajisjet frigoriferike me një ndarje ftohëse, me një vëllim të ruajtjes të paktën 15 litra

Vlerat M dhe N jepen në tabelën 7 për çdo kategori të pajisjes frigoriferik për përdorim shtëpiak.

TABELA 7  
VLERAT M DHE N SIPAS KATEGORISË SË PAJISJEVE FRIGORIFERIKE PËR PËRDORIM  
SHTËPIAK

| Kategoria | M     | M   |
|-----------|-------|-----|
| 1         | 0,233 | 245 |
| 2         | 0,233 | 245 |
| 3         | 0,233 | 245 |
| 4         | 0,643 | 191 |
| 5         | 0,450 | 245 |
| 6         | 0,777 | 303 |
| 7         | 0,777 | 303 |
| 8         | 0,539 | 315 |
| 9         | 0,472 | 286 |
| 10        | (*)   | (*) |

\*) Shënim. Për kategorinë 10 të pajisjeve frigoriferike vlerat M dhe N të varen nga temperatura dhe numri i yjeve i ndarjes me temperaturën më të ulët të ruajtjes që mund të vendoset nga përdoruesi i fundit dhe mbahet vazhdimisht në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Kur ka vetëm një “ndarje tjetër” siç përcaktohet në tabelën 2 pika 7 (n), përdoren vlerat M dhe N të kategorisë 1. Pajisjet me ndarje me tri yje apo ndarjet për artikuj ushqimorë të ngrirë konsiderohen frigoriferë ngrirës.

10. Klasat e efencës së energjisë

Klasa e efencës së energjisë për një pajisje frigoriferike përcaktohet në bazë të indeksit të efencës së saj të energjisë (EEI) siç është përcaktuar në tabelën 1.

Indeksi i efencës së energjisë i pajisjes frigoriferike përcaktohet në përputhje me pikën 9.3.

TABELA 1  
KLASAT E EFICENCËS SË ENERGJISË DERI NË 30 QERSHOR 2014

| Klasa e efencës së energjisë | Indeksi i efencës së energjisë |
|------------------------------|--------------------------------|
| A+++ (më efiente)            | $EEI < 22$                     |
| A++                          | $22 \leq EEI < 33$             |
| A+                           | $33 \leq EEI < 42$             |
| A                            | $42 \leq EEI < 55$             |
| B                            | $55 \leq EEI < 75$             |

|                      |                      |
|----------------------|----------------------|
| C                    | $75 \leq EEI < 95$   |
| D                    | $95 \leq EEI < 110$  |
| E                    | $110 \leq EEI < 125$ |
| F                    | $125 \leq EEI < 150$ |
| G (më pak eficiente) | $EEI \geq 150$       |

TABELA 2  
KLASA E EFICENCËS SË ENERGJISË NGA 1 KORRIK 2014

| Klasa e eficientës së energjisë | Indeksi i eficientës së energjisë |
|---------------------------------|-----------------------------------|
| A+++ (më eficiente)             | $EEI < 22$                        |
| A++                             | $22 \leq EEI < 33$                |
| A+                              | $33 \leq EEI < 42$                |
| A                               | $42 \leq EEI < 55$                |
| B                               | $55 \leq EEI < 75$                |
| C                               | $75 \leq EEI < 95$                |
| D                               | $95 \leq EEI < 110$               |
| E                               | $110 \leq EEI < 125$              |
| F                               | $125 \leq EEI < 150$              |
| G (më pak eficiente)            | $EEI \geq 150$                    |

